

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion.

Përshëndetje,

Në lidhje me kërkesën tuaj, të paraqitur pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 25.2.2026, në të cilën kërkonti informacion në lidhje për subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi materialeve inerte në lumin Shkumbin dhe më gjerë, ju informojmë si më poshtë vijon:

Referuar Ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, sipas pikës 1, të nenit 137: *“Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje për shfrytëzimin e materialeve inerte, si: rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë”*, sipas pikës 2, po të këtij neni: *“Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit përcakton kushtet dhe kriteret për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e materialeve inerte”*, ju informojmë mbi subjektet e pajisura me leje aktive për marrje materialeve inertesh dhënë nga KBL-të dhe KKTU-ja.

Vlen të theksohet që subjektet të cilat janë të pajisura me leje për marrje inertesh lumore nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (KBL, KKTU), janë bazuar në Ligjin Nr.29/2024 dhe VKM-së Nr. 319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", ku trajtohen aplikimet në sistem me dokumentacionin përkatës bazuar në dispozitat ligjore, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM Nr.319, ku në vijim propozojnë pranë Këshillit të Basenit Lumor ose Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit përkatës trajtimin dhe miratimin e lejes.

Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje Përdorimi Burimi Ujor, 4-subjekte që kryejnë këtë aktivitet në lumin Shkumbin, sipas tabelës së më poshtme:

NR	SUBJEKTI	BASENI UJOR	Dt. Leje/Autorizim	Dt. Perfundimi Leje/Autorizim	INERTE Vol. total Shfrytezim m3	SASITE E MARRA deri 28.2.2026	Detaje te Qellimit	Emri i Burimit
1	ALB-BUILDING	Shkumbin	4.8.2023	sipas kontrates por jo me shume se 4.8.2026	619637	506 000	për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)”	Lumi Shkumbin

2	ANK	Shkumbin	19.12.2024	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet 19.12.2027	71561	22000	Zgjerimi I rruges "Elbasan-Qafethane" (Faza 4)	LUMI SHKUMBIN
3	SALILLARI SH.P.K	Shkumbin	04.06.2025	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet	425000	425000	Ndertimi aksi rrugor Elbasan - Paper (Faza I)	Lumi Shkumbin
4	Alb Building shpk	Shkumbin	24.07.2025	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet	226807	43000	Ndertimi aksi rrugor Paper- Ura e Grykshit (Faza III)	Lumi Shkumbin

Sa më sipër, çdo subjekt apo individ që ushtron aktivitet në shtretërit e lumenjve, në zonat pranë tyre apo kryen shfrytëzim të materialeve inerte dhe *që nuk rezulton i përfshirë në listën e subjekteve të autorizuar që po ju përcillet*, konsiderohet se operon pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin dhe përdorimin e burimeve ujore.

Në kuadër të kontrollit administrativ të përdorimit të burimeve ujore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe bashkëpunon me Zyrat e Administrimit të Baseneve Lumore, realizon monitorim të vazhdueshëm të subjekteve që disponojnë leje ose autorizime për përdorim burimi ujor, mbi verifikimin e respektimit, sipas përcaktimeve ligjore të kushteve të lejeve.

Nga monitorimet periodike, kryer nga Zyrat e Administrimit të Baseneve Lumore për subjektet me leje aktive për marrje materialesh inerte, nuk janë evidentuar raste të problematikave lidhur me mosrespektimin e kushteve të lejes, ku nga 4-ZABL-të nuk janë konstatuar subjekte në shkelje të lejeve dhënë nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (KBL, KKTU), ku kryesisht subjekteve në fjale ju është lënë detyra që të respektojnë zonën e shfrytëzimit të materialeve inerte miratuar nga Këshilli Basenit Lumor/Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit si dhe të raportojë pranë ZABL-ve mbi sasisë e marra. Për të gjithë subjektet me leje inertesh nga ZABL-të janë realizua monitorime në zbatim të planeve të punës.

Subjektet faturohen sipas VKM-së Nr. 993 ,datë 09.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrativë të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre” Tabela nr.1 pika nr.37, ku tarifa e përdorimit për shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë është 2 % e vlerës së materialit të shitur. Subjektet dërgojnë informacion pranë ZABL-ve përkatëse mbi sasisë e materialeve inerte të shfrytëzuar dhe në fund të çdo viti realizohet rakordimi me ARRSH-në mbi sasisë e inerteve në preventivat përkatës.

AMBU dhe strukturat e saj rajonale ZABL Vjosë, Shkumbin-Seman, Ishëm-Erzen-Mat dhe Drin-Bunë në zbatim të ligjit Nr.29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar për çdo rast njoftojnë zyrtarisht Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes dhe Territorit (IKMT), duke kërkuar marrjen e masave korrigjuese nga subjektet brenda afateve të përcaktuara, me qëllim rikthimin e përputhshmërisë me kushtet e lejes dhe kërkesat ligjore, në raste konstatimi të shkeljeve.

Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje

Përdorimi Burimi Ujor (në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë) 9- subjekte që e kryejnë këtë aktivite, sipas tabelës së mëposhtme:

Subjekti	Baseni Ujor	Dt. Leje/Autorizim	Dt. Perfundimi Leje/Autorizim	Inerte Vol. Total Shfrytezim M3	Qëllimi përdorimit	Detaje te qellimit	Emri i burimit ku shfrytëzohet
“SALILLARI ” SH.P.K	Mat	10.08.2020	Në përputhje me afatet e koncesionit	603 194	156 498	Shfrytëzim të materialeve inerte për realizimin e kontratës “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë”	Lumi Fan
ALB-BUILDING	Shkumbin	4.8.2023	sipas kontrates por jo me shume se 4.8.2026	619 637	506 000 Në përfundim	për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)” REF-42845-09-21-2022 me Nr. 77/88/6, prot, datë 05.12.2022	Lumi Shkumbin
ANK	Shkumbin	19.12.2024	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet 19.12.2027	71 561	22 000	Zgjerimi I rruges "Elbasan-Qafethane" (Faza 4)	Lumi Shkumbin
Fusha SH.P.K	Vjose	23.12.2024	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet	60 000	Ska filluar	Shfrytëzimi i materialit inert për zbatimin e projektit: “Rikualifimi i vijës bregdetare Vlorë – Radhimë – Orikum, Faza 2 (Loti 3)”.	Perroi Vilavet Lumi Dukat
4 A-M	Shkumbin	17.04.2024	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet 11.4.2027	316 483	277 113	Zgjerimi i rruges "Elbasan-Qafethane" (Faza 2)	Lumi /Zalli Gostimë
BAMI HOLDING	Mat	25.06.2025	sipas kontrates por jo me shume se 25.06.2028	60 000	20 000	Shfrytezimin e inerteve lumore ne shtratin e Perroit te Hurdhes per zbatimin e projektit “Zgjerimi i superstrades Tirane - Durres (Faza I)”	Perroi Hurdhes
SALILLARI SH.P.K	Shkumbin	04.06.2025	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet	425 000	425 000 Ka mbaruar	Ndertimi aksi rrugor Elbasan - Paper (Faza I)	Lumi Shkumbin
Alb Building shpk	Shkumbin	24.07.2025	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet	226 807	43 000	Ndertimi aksi rrugor Paper- Ura e Grykshit (Faza III)	Lumi Shkumbin
2T SH.P.K	Shkumbin	22.07.2025	Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet	301840	80 560	Ndertimi aksi rrugor Elbasan - Paper (Faza III)	Lumi /Zalli Paperr

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.